



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.563/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---------------|------------|
| Jonaid Myzyri | Kryetar |
| Enkeleda Bega | Nënkryetar |
| Vilma Zhupaj | Anëtar |
| Lindita Skeja | Anëtar |
| Merita Zeqaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 09.12.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: “Kundërshtimi i vendimit të KVO lidhur me vlerësimin në pikë të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Doda-R” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “E Kufizuar (mbi kufirin e lartë monetar)”, me nr.REF-65283-07-13-2020, me objekt Loti XII “Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga "Kuben- Vasie” me fondin limit 117.790.800 Lekë pa tvsh , zhvilluar në datën 28.09.2020 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues: “Doda-R” sh.p.k.
Ndërtesa 3-katëshe, në vendin e quajtur “Kuben”, me zonë kadastrale nr. 2958, Nr, pasurie 175/33 Pilafe, Tomin Dibër

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar
Rruga “Sami Frashëri”, nr. 33, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i

ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.07.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “E Kufizuar (mbi kufirin e lartë monetar)”, me nr.REF-65283-07-13-2020, me objekt Loti XII “Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga "Kuben- Vasio” me fondin limit

117.790.800 Lekë pa tvsh , zhvilluar në datën 28.09.2020 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë KPP më shkresën nr8750/1 datë 16.11.2020 si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se në datën 05.08.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit). Në këtë fazë kanë marrë pjesë operatoët si më poshtë.

- “6D-Plan sh.p.k. skualifikuar
- “Doda-R” sh.p.k. kualifikuar
- “Sireta -2 F” sh.p.k. skualifikuar
- “ Alko Impex General Construction”dshh & “Alko Impex Construction”shpk kualifikuar

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se pas mbylljes së fazës së parë dhe në përfundim të afateve të ankimit autoriteti kontraktor më datë 09.09.2020 me shkresën nr. 4758/17prot., nëpërmjet sistemit elektronik ka drejtuar tek operatorët ekonomikë ftesën për ofertë. Data e përcaktuar për hapjen e ofertave është data 28.09.2020 ora 14:00. Operatorët që i janë përgjigjur ftesës për dorëzimin e ofertës ekonomike janë:

| Nr. | Operatori ekonomik | Cmimi total i ofertës në lekë pa përfshire vlerën TVSH-së Para korigjimit | Pas Korigjimit |
|-----|---|---|----------------|
| 1. | “Doda-R” sh.p.k. | 113.846.713,24 | |
| 2. | BOE “Alko Impex General Construction”dshh & “Alko Impex Construction”shpk | 114.323.742 | |

Në datën 28.09.2020 është zhvilluar faza e dytë e procedurës së prokurimit për dorëzimin e propozime teknike dhe ekonomike.

II.4. Në datën 20.10.2020 KVO-ja përfundoi vlerësimin në pikë të operatorëve ekonomikë si më poshtë:

1. “Doda-R” sh.p.k.

| Anëtari i KVO-së | Oferta ekonomike | Pikët për cmimin | Pikët përvoja në punë e kompanisë | Pikë cilësia metodologjia makineri etj | Total Cilësi ∑ 1+2+3 |
|------------------|------------------|------------------|-----------------------------------|--|-------------------------|
| | | | | | |

| | | | | | |
|---|----------------|----|----|----|----|
| 1 | 113.846.713,24 | 60 | 15 | 18 | 93 |
| 2 | 113.846.713,24 | 60 | 15 | 18 | 93 |
| 3 | 113.846.713,24 | 60 | 15 | 18 | 93 |

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 93 pikë.(bashkëlidhur argumentimi i pikëve nga anëtarët e KVO-së

2. Boe “Alko Impex General Construction”dshh & “Alko Impex Construction”shpk

| Anëtari i KVO-së | Oferta ekonomike | Pikët për cmimin | Pikët përvoja në punë e kompanisë | Pikë cilësia metodologjia makineri etj | Total Cilësi $\sum 1+2+3$ |
|------------------|------------------|------------------|-----------------------------------|--|---------------------------|
| 1 | 114.323.742 | 59 | 18 | 18 | 95 |
| 2 | 114.323.742 | 59 | 18 | 18 | 95 |
| 3 | 114.323.742 | 59 | 18 | 18 | 95 |

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 95 pikë.(bashkëlidhur argumentimi i pikëve nga anëtarët e KVO-së.

Renditja përfundimtare e operatorëve ekonomikë do të jetë:

| Nr. | Operatori ekonomik | |
|-----|---|----|
| 1 | Boe “Alko Impex General Construction”dshh & “Alko Impex Construction”shpk | 95 |
| 2 | “Doda-R” sh.p.k. | 93 |

II.6. Në datën 26.10.2020, operatori ekonomik “Doda-R” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, në mënyrë të përmbledhur me pretendimet si më poshtë: [...]

Në datën 28.09.2020 ARRSH, zhvilloi fazën e dytë të procedurës së kufizuar të prokurimit me objekt Loti XII “Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga “Kuben- Vasie” me fondin limit 117.790.800 Lekë pa tvsh , në të cilën oe “Doda-R” sh.p.k. u paraqit si ofertues në vijim të ftesës për ofetë të paraqitur nga AK-ja për këtë procedurë.

Në datën 20.10.2020në faqen zyrtare të APP-së jemi informuar mbi vlerësimin përfundimtar dhënë nga KVO-ja për këtë procedurë si më poshtë vijon:

| Nr. | Operatorët ekonomikë | Vlerat e ofertuara | Refuzuar/Pranuar |
|-----|----------------------|--------------------|------------------|
| 1. | “Alko-Impex | 128.00 pikë | pranuar |

| | | | |
|----|---|--------------------|----------------|
| | <i>General Construcion” sh.p.k.</i> | | |
| 2. | <i>“Doda-R” sh.p.k.</i> | <i>127.80 pikë</i> | <i>pranuar</i> |

Nga informacioni i transmetuar po në rrugë elektronike jemi njoftuar për shumën ëe pikëve që na janë dhënë në këtë procedurë prokurimi dhe asnjë e dhënë mbi ofertat e paraqitura apo mënyrën e vlerësimit të bërë. Për këtë i jemi drejtuar Ak-së me një kërkesë për informacion detyrim ky që rrjedh nga rregullat e prokurimit publik. Në vend që të informoheshim në rrugë elektronike për vet situatën e pandemisë dhe distancës fizike me mbi 150 km, AK-ja zgjedhi mënyrën më të vështirë duke na ftuar të paraqiteshim në institucion për ta tërhequr atë. Në këtë mënyrë do të kalonte afati prej 7 ditësh për të paraqitur ankesë pranë institucionit. Gjithsesi Në këtë procedurë prokurimi oferta ekonomike e dhënë nga ana jonë ishte 113.863.380 lekë pa TVSH dhe më e ulët se operatori tjetër konkuroes në këtë procedurë prokurimi. Duke mos qënë dakord me vlerësimin e dhënë ndaj subjektit ton paraqesim në vijim ankesën tonë dhe argumentat përkatëse të cilat shpresojmë të merren parasysh nga ana juaj.

Në dst seksioni 4

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) **çmimi më i ulët**

Ose

B) **oferta ekonomikisht më e favorshme**

lidhur me rëndësinë: Çmimi pikë

etj. pikë

Kriteret e Vlerësimit

Pikët

(i) **Çmimi më i ulët**

[0-60]

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë ofertën.

(ii) **Pervoja ne pune e kompanise**

[0-20]

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë punet e relalizuuar ne forme CV, shoqeruar me

vertetim punimesh, te kryera ne 10 viteve te fundit.

(iii) **Cilësia**

[0 - 20]

Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.

Ndërsa në kapitullin II Udhëzime për oe Seksioni 5 vlerësimi i ofertave është dhënë:

5.1 Kriteret e përzgjedhjes

(Opsioni 1) Çmimi më i ulët i ofertës së kualifikuar.

Kontrata do t'i akordohet atij Ofertuesi që ka ofruar çmimin më ulët të ofertës së kualifikuar.

(Opsioni 2) Oferta ekonomikisht më e favorshme.

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter dmth sa pikë do të ketë çdo kriter dhe si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën do të llogariten pikët e ofertuesve në këtë rast është:

$$P_o = P_{k1} + P_{k2} + P_{k3} + \dots$$

Ku:

P_o - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

P_{k1}/P_{k2}/P_{k3}/... - janë pikët për çdo kriter të vlerësuar

Pikët për çdo kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{min k1} \times P_{max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{min k1} _____ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

P_{max k1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Nga ana jonë kostatohet që vlerësimi nuk është bërë në përputhje me formulën e dhënë më sipër. Nisur nga parashkimi ligjor që "Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë

100” rezulton që vlerësimi në sistem është kryer me pikë që kanë tejkaluar përcaktimin e dhënë më sipër me dokumentat e tenderit.

Udhëzimi në dokumentat e tenderit i sipërcituar përkufizon saktë mënyrën e llogaritjes së pikëve duke mbledhur për çdo kriter. Ky i fundit del nga raporti midis ofertës që vlerësohet dhe prodhimit të vlerës minimale të ofruar me pikët maksimale. Moszbatimi sic duhet i formulës së përcaktuar në dst normalisht do të çojë në parregullësi proceduriale të procedurës së prokurimit publik dhe vlerësimin subjektiv jo në përputhje me LPP-në.

Sqarojmë se nga ana jonë janë përmbushur maksimalisht të tre komponentët e marra për vlerësim dhe krahasimisht me operatorin konkures ne duhet të ishim në vendin e parë.

1. *Oferta ekonomike e dhënë nga ana jonë është 113.863.380 lekë pa tvsh dhe më ulët se operatori ekonomik tjetër konkures në këtë procedurë prokurimi. Bazuar në përcaktimin e dhënë në dst ne duhet të jemi vlerëuar me pikët maksimale për këtë kriter pra me 60 pikë.*
2. *Në lidhje me punët e realizuara në formë cv shoqëruar me vërtetim punimesh të kryera në 10 vitet e fundit. Nisur nga sa më sipër referuar objektit të prokurimit operatori ynë ekonomik në veprimtarinë e tij shfaq një eksperiencë shumë të gjatë dhe të thelluar në fushën e ndërtimit dhe mirëmbajtjes në përgjithësi ku përfshihen edhe mirëmbajtje të akseve të ndryshme rrugore duke vërtetuar se ka kryer shërbime të njëjta me objektin e prokurimit. Me dokumentacionin e paraqitur nga ana jonë kemi dëshmuar se kemi realizuar kontrata të ngjashme të njëjta me objektin e prokurimit e si rrjedhim kërkojmë një vlerësim afër kufirit maksimal të përcaktuar në këtë kriter.*

Nga ana jonë janë paraqitur kontratat e mëposhtëme

Kontrata shërbimi për mirëmbajtjen e rrugeve të antenave të AMC-se për zonen e veriut, me vlerë 20.851.599, viti 2011.

Mbushje me cakull, vendosje tombinash në aksin Rrugor Ura e Cerencit Stebleve, me vlerë 11.490.951 leke, financuar nga Drejtoria Rajonale Rrugore, Diber, për vitin 2012.

Mirëmbajtje dhe sistemim i sheshit para godinës së kështjës, Spitali Rajonal Peshkopi, me vlerë 21.520.342 leke, Financuar nga Drejtoria e Spitalit Rajonal, Diber për vitin 2012.

Ndërtim i Shkolles CU Fshati Bardh - Rec, Komuna Zall Rec, me vlerë 17.799.406, financuar nga buxheti i komunes për vitin 2012.

Emergjence mirëmbajtje dimrore, pastrim i bores, Aksi Rrugor Ura e Cerencit - Stebleve, me vlerë 24.924.811 leke, financuar nga Drejtoria Rajonale Rrugore Diber.

Mirmbajtje rutine e dimrore Rruga Kuben-Prroi Kapcit -Vleshë -Vasie 34.5 km me vlere totale 30.981.947 leke, financuar nga Drejtoria e Rajonale Rrugore Dibër per vitin 2013-2015.

Rikonstruksioni i varrezave publike te Qytetit Peshkojme vlerë 13.314.879 leke, financuar nga Bashkia Dibër për vitin 2017.

Rindertimi i ures HD= Sm, ne Fshatin Krej-Lure, Lure, me vlere 3.864.240lekë , financim Bashkia Diber, viti 2017.

Kanali Muhurr - Brezhdan pjesa e Gjorices dhe riparim i sifonit Gjaric -Vakuf, Kanali Set Dardhe, me vlere 38.169.546 leke, financuar nga Bashkia Diber, viti 2018.

Rehabilitimi i ambjenteve te jashtme edhe terreneve Sportive te Shkolles se Mesme Macellare, financuar nga Ambasada Zvicerane neprmjet Bashkis Diber me vlere 14.038.747 leke, Bashkia Diber, viti 2018.

Rehabilitim i ujsjellesit te Sobanikes me vlere 2.488.000 Jeke, financuar nga Drejtoria e Ujsjelles Kanalizimeve Diber, per vitin 2018.

Rikonstruksion + shtese +ngritje ne kat 3 >4 e Objektit egzistues Lagja Tregu Peshkopi, me vlere 15.607.440 leke, financuar nga subjekti Andrea Manga, per vitin 2018.

Mirmbajtje rutine dhe dimerore me performance Rruga Kuben -Vasie 35.4 km, financuar nga Drejtoria Rajoni Verior, Shkoder, me vlere 35.788.773 Jeke, si nenkontraktor per vitin 2019-2020.

Procesi i pikezimit ne procedurat me kriter perzgjedhje Oferta ekonomikisht me e favorshme, duhet te behet ne perputhje dhe ne proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjeter, duhet te jete sa me afer kerkesave dhe kriterëve te percaktuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit te prokurimit publik, eshte e tille qe, cdo operator duhet te pergatise oferten e tij ne perputhje me kriteret dhe kerkesat e parashikuara ne dokumentat e tenderit. Ne rastin konkret, kriteri i percaktuar nga autoriteti kontraktor per " ... punet e realizuar ne forme CV, shoqeruar me vertetim punimesh, te kryera ne 10 viteve te fundit." ne fushen e zbatimit, eshte plotesuar me se miri nga ana jone.

Nga dokumentacionit i paraqitur nga ana jone konstatohet se kemi nje eksperience te gjate e te ngjashme, madje dhe te njejte me proceduren e prokurimit objekt shqyrtimi. Ne tashme e dime qe eshte e vertete se, vleresimi me pike bazohet ne gjykimin personal dhe individual te secilit prej anetareve te komisionit te vleresimit te ofertave, brenda diapazonit me pike, te percaktuar ne dokumentat e tenderit, por nga ana tjeter ky vleresim dhe gjykim, nuk duhet te jete subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesemarres ne proceduren e prokurimit, duke mos dhene vleresime me ndryshime te dukshme e te thella, ne kushtet kur, dukshem, operatori ekonomik provon dhe verteton se ka paraqitur nje dokumentacion te plote e te mjaftueshem per t'u vleresuar me piket maksimale.

Ne rastin konkret, theksojme se nga ana jone jane paraqitur dokumentacion te shumte ne lidhje me eksperiencat e meparshme te ngjashme, duke paraqitur nje sere kontratash me objekt te ngjashme te njejte me objektin e prokurimit objekt shqyrtimi, cka rrjedhimisht

duhet te vleresohet, duke u finalizuar me vleresimin maksimal me pike nga ana Juaj. Autoriteti kontraktor, nuk mund te argumentoje se, nuk ka nje mates per percaktimin e sakte te vleresimit, pasi referuar dokumentacionit te paraqitur arrihet te behet nje vleresim i sakte dhe objektiv. Ne kushtet kur, nga ana jone eshte ngarkuar nje dokumentacion i plote ne lidhje me kontratat e ngjashme, duke u paraqitur nje numer i konsiderueshem kontratash te shtrira ne kohe dhe te lidhura dhe ekzekutuara me autoritete te ndryshme shteterore dhe private, aq me teper kur disa prej ketyre kontratave rezultojne te jene te njejta, rrjedhimisht vleresimi duhet te behet ne maksimumin e tij, bazuar dhe ne frymen e legjislacionit per prokurimin publik.

Vleresimi është i matëshëm në kushte kur niveli i pikëzimit është në raport me dokumentacionin e paraqitur pra vleresimi me pikë jepet duke analizuar kontratat e ngjashme ne teresine e tyre, duke perfshire shume elemente te tille si data e lidhjes, mënyra e realizimit, objekti i kontrates, vlera e saj etj, dhe rrjedhimisht vleresimi maksimal nuk mund të jepet duke pare dhe analizuar vetëm numrin e kontratave të paraqitura pa realizuar brendinë e tyre me të gjithë elementët e përmendur më sipër. Nga këto konstatime kuptohet qartë që nga ana jonë është plotësuar ky kriter në maksimumin e tij, i cili nga na tjetër do të duhej të përkthehej nga KVO-ja me një vlerësim sda më objektiv dhe real në favorin tonë pra me 20 pikë dhe gjithsesi krahasimisht më shumë se operatori tjetër konkures.

3. Ne lidhje me treguesit dhe analiza cilesore ne pune duke percaktuar elementet e saj si per shembull por pa u limituar ne cilesine e propozimit teknik per sa i perket metodave te perdorura, personelit kryesor, disponueshmerise se pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit te cilesise, planit te mobilizimit, grafikut te punimeve dhe cdo aktiviteti tjetër sic mund te percaktohet nga punedhenesi.

Referuar frymes se legjislacionit per prokurimin publik, vendosja e kriterëve te vecanta per kualifikim ka si synim kryesor qe t'i sherbeje autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Gjykojme qe vleresimi eshte i matshem ne kushtet kur, niveli i pikezimit eshte ne raport me dokumentacionin e paraqitur, pra vleresimi me pike jepet duke analizuar dokumentacionin e paraqitur ne lidhje me stafin, duke perfshire shume elemente te tillë si numri i personelit, eksperiencia, profesionet, vitet e punes prane shoqerise ankimuese, etj., dhe rrjedhimisht vleresimi maksimal nuk mund te jepet vetem duke pare dhe analizuar vetem ne menyre siperfaqesore pa realizuar brendine e tyre me te gjithë elementet e përmendur me siper.

Nga ana jonë është paraqitur staf i kualifikuar i pangazhuar në ansjë kontratë tjetër i përbërë nga:

- Ramazan DODA Drejtues Ligjor
- Kozma SEMANI Ing. Ndertimi Drejtues Teknik

- *Merxhan DUKA Ing. Topograf Drejtues Teknik*
- *Ylber CANI Ing. Mjedisi Drejtues Teknik*
- *Skender LEKA Ing. Mekanik Drejtues teknik*
- *Miftar MAJMARI Ing. Gjeolog*
- *Eduart DELISHI Ing. Ndertimi*
- *Shkelzen DODA Ekonomist i Iarte*
- *Asllan RINA Teknik Ndertimi*
- *Nesaht DODA Specialist i Mesem Mekanik dhe Manovrator*
- *Lumturi DODA Manovrator*
- *Robert DODA Manovrator*
- *Jonis HOXHA Manovrator*
- *Qerim DODA Manovrator*
- *Kastriot CANI Manovrator*
- *Atli T ANUSHI Spcialist Ndertimi*
- *Ervin SHINI Arkitekt*
- *Arben LEKA Ing. Elektrik*
- *Harnit SKANA Ing. Hidroteknik*

Stafi i mesiperm eshte disponibel vetem per kete kontrate dhe krahasueshmerisht dukshem me mire se operatori tjetër ekonomik i cili ka shume kontrata ne zbatim dhe staf qe nuk eshte ne Shqiperi por ne Kosove.

Po keshtu kapacitetet teknike sa i perket mjetet dhe pjisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates, jane paraqitur te gjitha thujse ne pronesi të operatorit ekonomik Ne e dime qe LPP-ja dhe nga ana juaj eshte lejuar qe keto kapacitetete jene të siguruara dhe nëpërmjet qirase, por sidoqofte pasja ne pronesi e tyre, eshte kosto shtese e jona, si siguri absolute per realizimin e kontrates gje e cila duh et te vleresohet nga ana juaj, e shprehur ne piket maksimale.

Ne lidhje me treguesit dhe analiza cilesore ne pune duke percaktuar elementet e saj si per shembull por pa u limituar ne cilesine e propozimit teknik per sa i perket rnetodave te perdorura, personelit kryesor, disponueshmerise se pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit te cilesise, planit te mobilizimit, grafikut te punimeve dhe cdo aktiviteti tjetër sic mund te percaktohet nga punedhenesi, nga ana jone jane paraqitur te gjithë elementet e sipercituar, duke permbushur kriterin e dhene nga ana juaj.

Nga KVO-ja duhet te mbahej parasysh vleresimi me nje standandart, sic kane vepruar me operatoret e tjere ne kontrata te mirembajtjes ne Tropoje, Kukes, Korce, Sarande etj, duke vleresuar me me shume pike, pikerisht operatoret lokal, me argumentimin qe e njohin me mire dhe jane ne gjendje te organizojne me mire kantierin. Operatori konkurues rezulton qe eshte nga Kosova dhe te gjitha punet ne vendin tone nuk kryen vete, po nepermjet nenkontraktoreve dhe kjo gje dihet fare mire nga ana juaj. Dhe per kete kriter operatori yne ekonomik duhej te ishte vleresuar me 20 pike dhe ne cdo rast me shume se konurenti.

Ne keto kushte rrjedhimisht vlerësimi ndaj operatorit tone ekonomik Doda R shpk, duhet te ishte 100 pike dhe ne cdo rast me shume se operatori tjetër konkurrues.

KVO-ja nuk ka zbatuar sic duhet nenin 55 pika 1/b po ashtu dhe pikën 2 të LPP-së i referojmë[...].

Gjithashtu neni 1.2 të LPP-së i referojmë [...]

Gjykojmë që vlerësimi juaj për këtë procedurë prokurimi është i pabazuar në lpp-në dhe VKM-në RrPP-së[...], po kështu në shkelje të kriterëve të vlerësimit të dhëna në DS të kësaj procedure.[...]

II.7. Në datën 30.10.2020 nëpërmjet shkresës me nr.8131/2 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.8. Në datën 09.11.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor me argumentat si më poshtë vijon:

Në datën 28.09.2020 ARRSH, zhvilloi fazën e dytë të procedurës së kufizuar të prokurimit me objekt Loti XII “Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga “Kuben- Vasie” me fondin limit 117.790.800 Lekë pa tvsh , në të cilën oe “Doda-R” sh.p.k. u paraqit si ofertues në vijim të ftesës për ofetë të paraqitur nga AK-ja për këtë procedurë.

Në datën 20.10.2020 në faqen zyrtare të APP-së jemi informuar mbi vlerësimin përfundimtar dhënë nga KVO-ja për këtë procedurë si më poshtë vijon:

| <i>Nr.</i> | <i>Operatorët ekonomikë</i> | <i>Vlerat e ofertuara</i> | <i>Refuzuar/Pranuar</i> |
|------------|---|---------------------------|-------------------------|
| <i>1.</i> | <i>“Alko-Impex General Construcion” sh.p.k.</i> | <i>128.00 pikë</i> | <i>pranuar</i> |
| <i>2.</i> | <i>“Doda-R” sh.p.k.</i> | <i>127.80 pikë</i> | <i>pranuar</i> |

Nga informacioni i transmetuar po në rrugë elektronike jemi njoftuar për shumën e pikëve që na janë dhënë në këtë procedurë prokurimi dhe asnjë e dhënë mbi ofertat e paraqituara apo mënyrën e vlerësimit të bërë. Për këtë i jemi drejtuar Ak-së me një kërkesë për informacion detyrim ky që rrjedh nga rregullat e prokurimit publik. Në vend që të informoheshim në rrugë elektronike për vet situatën e pandemisë dhe distancës fizike me mbi 150 km, AK-ja zgjedhi mënyrën më të vështirë duke na ftuar të paraqiteshim në institucion për ta tërhequr atë. Në këtë mënyrë do të kalonte afati prej 7 ditësh për të paraqitur ankesë pranë institucionit. Gjithsesi Në këtë procedurë prokurimi oferta ekonomike e dhënë nga ana jonë ishte 113.863.380 lekë pa TVSH dhe më e ulët se operatori tjetër konkurrues në këtë procedurë prokurimi. Duke mos qënë dakord me vlerësimin e dhënë ndaj subjektit tonë kemi paraqitur ankesë pranë AK-së në theks kundërshtimet tona dhe argumentat përkatëse.

ARRSH në cilësinë e ak-së nuk ka marrë parasysh ankesën tonë duke e refuzuar atë dhe na ka kthyer përgjigje dorëzuar “Doda-R” shpk nga posta shqiptare 05.11.2020.

Si fillim sqarojmë që vendimi i mësipërm edhe pse në paragrafin e fundit thotë që do të dërgohet të nesërmen me mail nuk është dërguar dhe oe ynë ka marrë dijëni 05.11.2020 në cdo rast duam të vëmë në dijëni tuaj:

Referojmë nnin 63 të LPP-së.

Referojmë ligjin 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative Neni 56 Llogaritja e afateve [...]

Gjithsesi duke qënë se administrativisht kemi të drejtë të ankohe mi në KPP edhe në rast se do të mbetemi pa përgjigje nga AK-ja (në fakt kjo e fundit nuk rezulton të ketë ndryshuar asnjë vendim të dhënë më parë), duke gjykuar që na është cënuar e drejta jonë e konkurimit në shkelje të ligjit dhe rregullave të prokrimit publik kërkojmë mbështetjen tuaj ligjore për vënien në vend të së drejtejtës së mohuar. Kështu,

Në dst seksioni 4

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) çmimi më i ulët

Ose

B) oferta ekonomisht më e favorshme *X*

lidhur me rëndësinë: Çmimi pikë

etj. pikë

Kriteret e Vleresimit

Pikët

(i) Çmimi më i ulët

[0-60]

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë ofertën.

(ii) Pervoja ne pune e kompanise

[0-20]

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë punet e relalizuar ne forme CV, shoqeruar me

vertetim punimesh, te kryera ne 10 viteve te fundit.

(iii) Cilësia

[0 - 20]

Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.
Ndërsa në kapitullin II Udhëzime për oe Seksioni 5 vlerësimi i ofertave është dhënë:

5.1 Kriteret e përzgjedhjes

(Opsioni 1) Çmimi më i ulët i ofertës së kualifikuar.

Kontrata do t'i akordohet atij Ofertuesi që ka ofruar çmimin më ulët të ofertës së kualifikuar.

(Opsioni 2) Oferta ekonomikisht më e favorshme.

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter dmth sa pikë do të ketë çdo kriter dhe si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën do të llogariten pikët e ofertuesve në këtë rast është:

$$P_o = P_{k1} + P_{k2} + P_{k3} + \dots$$

Ku:

P_o - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

P_{k1}/P_{k2}/P_{k3}/... - janë pikët për çdo kriter të vlerësuar

Pikët për çdo kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{min k1} \times P_{max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{min k1} Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

P_{max k1} Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Nga ana jonë kostatohet që vlerësimi nuk është bërë në përputhje me formulën e dhënë më sipër. Nisur nga parashkimi ligjor që "Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100" rezulton që vlerësimi në sistem është kryer me pikë që kanë tejkaluar përcaktimin e dhënë më sipër me dokumentat e tenderit.

Udhëzimi në dokumentat e tenderit i sipërcituar përkufizon saktë mënyrën e llogaritjes së pikëve duke mbledhur për cdo kriter. Ky i fundit del nga raporti midis ofertës që vlerësohet dhe prodhimit të vlerës minimale të ofruar me pikët maksimale. Moszbatimi sic duhet i

formulës së përcaktuar në dst normalisht do të çojë në parregullësi procedurale të procedurës së prokurimit publik dhe vlerësimin subjektiv jo në përputhje me LPP-në.

Sqarojmë se nga ana jonë janë përmbushur maksimalisht të tre komponentët e marra për vlerësim dhe krahasimisht me operatorin konkures ne duhet të ishim në vendin e parë.

- 1. Oferta ekonomike e dhënë nga ana jonë është 113.863.380 lekë pa tvsh dhe më ulët se operatori ekonomik tjetër konkures në këtë procedurë prokurimi. Bazuar në përcaktimin e dhënë në dst ne duhet të jemi vlerëuar me pikët maksimale për këtë kriter pra me 60 pikë, pasi kemi ofruar ofertën më të ulët ekonomike dhe në zbatim të përcaktimit të formulës së mësipërme rezulton s:*

$$Pk1 = V_{mink1} \times P_{max} K1/O k1 = 113.863.380 \times 60 / 113.863.380 = 60 \text{ pikë.}$$

- 2. Në lidhje me punët e realizuara në formë cv shoqëruar me vërtetim punimesh të kryera në 10 vitet e fundit. Nisur nga sa më sipër referuar objektit të prokurimit operatori ynë ekonomik në veprimtarinë e tij shfaq një eksperiencë shumë të gjatë dhe të thelluar në fushën e ndërtimit dhe mirëmbajtjes në përgjithësi ku përfshihen edhe mirëmbajtje të akseve të ndryshme rrugore duke vërtetuar se ka kryer shërbime të njëjta me objektin e prokurimit. Me dokumentacionin e paraqitur nga ana jonë kemi dëshmuar se kemi realizuar kontrata të ngjashme të njëjta me objektin e prokurimit e si rrjedhim kërkojmë një vlerësim afër kufirit maksimal të përcaktuar në këtë kriter.*

Nga ana jonë janë paraqitur kontratat e mëposhtëme

Kontrata shërbimi për mirëmbajtjen e rrugeve të antenave të AMC-se për zonen e veriut, me vlerë 20.851.599, viti 2011.

Mbushje me cakull, vendosje tombinash në aksin Rrugor Ura e Cerencit Stebleve, me vlerë 11.490.951 leke, financuar nga Drejtoria Rajonale Rrugore, Diber, për vitin 2012.

Mirëmbajtje dhe sistemim i sheshit para godinës së kështjës, Spitali Rajonal Peshkopi, me vlerë 21.520.342 leke, Financuar nga Drejtoria e Spitalit Rajonal, Diber për vitin 2012.

Ndërtim i Shkolles CU Fshati Bardh - Rec, Komuna Zall Rec, me vlerë 17.799.406, financuar nga buxheti i komunes për vitin 2012.

Emergjence mirëmbajtje dimrore, pastrim i bores, Aksi Rrugor Ura e Cerencit - Stebleve, me vlerë 24.924.811 leke, financuar nga Drejtoria Rajonale Rrugore Diber.

Mirëmbajtje rutine e dimrore Rruga Kuben-Prroi Kapcit -Vleshë -Vasie 34.5 km me vlerë totale 30.981.947 leke, financuar nga Drejtoria e Rajonale Rrugore Diber për vitin 2013-2015.

Rikonstruksioni i varrezave publike të Qytetit Peshkopi me vlerë 13.314.879 leke, financuar nga Bashkia Diber për vitin 2017.

Rindertimi i ures HD= Sm, ne Fshatin Krej-Lure, Lure, me vlere 3.864.240lekë , financim Bashkia Diber, viti 2017.

Kanali Muhurr - Brezhdan pjesa e Gjorices dhe riparim i sifonit Gjaric -Vakuf, Kanali Set Dardhe, me vlere 38.169.546 leke, financuar nga Bashkia Diber, viti 2018.

Rehabilitimi i ambjenteve te jashtme edhe terreneve Sportive te Shkolles se Mesme Macellare, financuar nga Ambasada Zvicerane neprmjet Bashkis Diber me vlere 14.038.747 leke, Bashkia Diber, viti 2018.

Rehabilitim i ujsjellesit te Sobanikes me vlere 2.488.000 Jeke, financuar nga Drejtoria e Ujsjelles Kanalizimeve Diber, per vitin 2018.

Rikonstruksion + shtese +ngritje ne kat 3 >4 e Objektivit egzistues Lagja Tregu Peshkopi, me vlere 15.607.440 leke, financuar nga subjekti Andrea Manga, per vitin 2018.

Mirmbajtje rutine dhe dimerore me performance Rruga Kuben -Vasie 35.4 km, financuar nga Drejtoria Rajoni Verior, Shkoder, me vlere 35.788.773 Jeke, si nenkontraktor per vitin 2019-2020.

Nisur nga sa më sipër referuar objektit të prokurimit oe ynë në veprimtarinë e tij shfaq një eksperiencë shumë të gjatë dhe të thelluar në fushën e ndërtimit dhe mirëmbajtjes në përgjithësi ku përfshihen edhe mirëmbajtje të akteve të ndryshme rrugore duke vërtetuar se ka kryer shërbime të njëjta me objektin e prokurimit. Me dokumentacionin e paraqitur mhaga ana jonë kemi dëshmuar se kemi realizuar kontrata të ngjashme/ të njëjta me objektin e prokurimit më shumë se të gjithë operatorët e ngjashë, e si rrjedhim kërkojmë një vlerësim në kufirin maksimal 20 pikë të përcaktuar për këtë kriter.

Procesi i pikezimit ne procedurat me kriter perzgjedhje Oferta ekonomikisht me e favorshme, duhet te behet ne perputhje dhe ne proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetere, duhet te jete sa me afer kerkesave dhe kriterete te percaktuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit te prokurimit publik, eshte e tille qe, cdo operator duhet te pergatise oferten e tij ne perputhje me kriteret dhe kerkesat e parashikuara ne dokumentat e tenderit. Ne rastin konkret, kriteri i percaktuar nga autoriteti kontraktor per " ... punet e realizuar ne forme CV, shoqeruar me vertetim punimesh, te kryera ne 10 viteve te fundit." ne fushen e zbatimit, eshte plotesuar me se miri nga ana jone. Duhet te lexojme me kujdes kriterin e dhene me sipër pra bëhet fjalë për punë të realizuara dhe jo shërbime specifike.

Nga dokumentacionit i paraqitur nga ana jone konstatohet se kemi nje eksperience te gjate e te ngjashme, madje dhe te njejte me proceduren e prokurimit objekt shqyrtimi. Ne tashme e dime qe eshte e vertete se, vleresimi me pike bazohet ne gjykimin personal dhe individual te secilit prej anetareve te komisionit te vleresimit te ofertave, brenda diapazonit me pike, te percaktuar ne dokumentat e tenderit, por nga ana tjetere ky vleresim dhe gjykim, nuk duhet te jete subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesemarres ne proceduren e prokurimit, duke mos dhene vleresime me ndryshime te dukshme e te thella, ne kushtet kur, dukshem, operatori ekonomik provon dhe verteton se ka paraqitur nje dokumentacion te plote e te mjaftueshem per t'u vleresuar me piket maksimale.

Ne rastin konkret, theksojme se nga ana jone jane paraqitur dokumentacion te shumte ne lidhje me eksperiencat e meparshme te ngjashme, duke paraqitur nje sere kontratash me objekt te ngjashme te njejte me objektin e prokurimit objekt shqyrtimi, cka rrjedhimisht duhet te vleresohet, duke u finalizuar me vleresimin maksimal me pike nga ana Juaj. Autoriteti kontraktor, nuk mund te argumentoje se, nuk ka nje mates per percaktimin e sakte te vleresimit, pasi referuar dokumentacionit te paraqitur arrihet te behet nje vleresim i sakte dhe objektiv. Ne kushtet kur, nga ana jone eshte ngarkuar nje dokumentacion i plote ne lidhje me kontratat e ngjashme, duke u paraqitur nje numer i konsiderueshem kontratash te shtrira ne kohe dhe te lidhura dhe ekzekutuara me autoritete te ndryshme shteterore dhe private, aq me teper kur disa prej ketyre kontratave rezultojne te jene te njejta, rrjedhimisht vleresimi duhet te behet ne maksimumin e tij, bazuar dhe ne frymen e legjislacionit per prokurimin publik.

Vlerësimi është i matëshëm në kushte kur niveli i pikëzimit është në raport me dokumentacionin e paraqitur pra vlerësimi me pikë jepet duke analizuar kontratat e ngjashme ne teresine e tyre, duke perfshire shume elemente te tille si data e lidhjes, mënyra e realizimit, objekti i kontrates, vlera e saj etj, dhe rrjedhimisht vleresimi maksimal nuk mund të jepet duke pare dhe analizuar vetëm numrin e kontratave të paraqitura pa realizuar brendinë e tyre me të gjithë elementët e përmendur më sipër. Nga këto konstatime kuptohet qartë që nga ana jonë është plotësuar ky kriter në maksimumin e tij, i cili nga na tjetër do të duhej të përkthehej nga KVO-ja me një vlerësim sda më objektiv dhe real në favorin tonë pra me 20 pikë dhe gjithsesi krahasimisht më shumë se operatori tjetër konkurses.

Në këtë rast vlerësimi do të duhet të ishte krahasimor në raport me operatorin ekonomik dhe cdo veprim subjektiv për ta duke dhënë pikë që nuk i meritojnë shkakton në mënyrë të drejtëpërdrejtë cvlerësimin e treguesve me pikë me qëllim që vlerësimi të ishte sa më objektiv. Në kushtet që kjo nuk është bërë bazuar në rregullat e prokurimit publik vlerësimi bëhet kryesisht për 3 vitet e fundit. Në këtë kuptim operatori ekonomik që ofron një numër më të madh të kontratave gjatë tri viteve të fundit, në harmoni kjo me vlerat e tyre duhet të vlerësohet objektivisht me më shumë pikë. Vlerësimi do të ishte objektiv kur të viheshin në vlerësim sipas rëndësisë së vlerës:

Kontrata në shërbim të njëjtë gjatë 3 viteve të fundit

Kontrata me shërbim të ngjashëm gjatë 3 viteve të fundit

Vlera e tyre në total

Kontrata në shërbim të njëjtë gjatë 10 viteve

Kontrata në shërbim të ngjashëm gjatë 10 iteve

Vlera e tyre ne total

Referojmë Rregullat e prokurimit në nenin 31 pika 2 [...]

[...] Përjashtues pikëve për kriterin e parë Oferta ekonomike të cilat rezultojnë të jenë dhënë sipas formulës së përcaktuar për pikëzimet e tjera nuk është zbatuar dispozita e mësipërme ligjore.

Për ofertën ekonomike rezulton që:

$PK1 = V_{\min} k1 \times P_{\max} k1 / O k1 = 113.863.380 \times 60 / 113.863.380 = 60$ pikë

Për punët e realizuar në formën CV shoqëruar me vërtetim punimesh të kryera në vitet e fundit

$Pk2 = V_{\min} k1 \times P_{\max} k1 / Ok1 = ?$

Për treguesit dhe analiza cilësore në punë

$Pk3 = V_{min} k1 \times P_{max} k1 / Ok1 = ?$

Për pikët e kritereve të tjera rezulton se nuk është zbatuar formula e dhënë dhe pikët janë vënë në mënyrë tërësisht subjektive.

3. Në lidhje me treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësive, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër sic mund të përcaktohet nga punedhësi.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të vecanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatoreve ekonomike, të cilet, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e aseteve të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Gjykojmë që vlerësimi është i matshëm në kushtet kur, niveli i pikezimit është në raport me dokumentacionin e paraqitur, pra vlerësimi me pike jepet duke analizuar dokumentacionin e paraqitur në lidhje me stafin, duke përfshirë shumë elemente të tillë si numri i personelit, eksperiencën, profesionet, vitet e punës pranë shoqërisë ankimuese, etj., dhe rrjedhimisht vlerësimi maksimal nuk mund të jepet vetëm duke parë dhe analizuar vetëm në mënyrë sipërfaqësore pa realizuar brendinë e tyre me të gjithë elementet e përmendur më sipër.

Nga ana jonë është paraqitur staf i kualifikuar i pangazhuar në ansjën kontratë tjetër i përbërë nga:

- Ramazan DODA Drejtues Ligjor*
- Kozma SEMANI Ing. Ndertimi Drejtues Teknik*
- Merxhan DUKA Ing. Topograf Drejtues Teknik*
- Ylber CANI Ing. Mjedisi Drejtues Teknik*
- Skender LEKA Ing. Mekanik Drejtues teknik*
- Miftar MAJMARI Ing. Gjeolog*
- Eduart DELISHI Ing. Ndertimi*
- Shkelzen DODA Ekonomist i Iartë*
- Asllan RINA Teknik Ndertimi*
- Nesaht DODA Specialist i Mesëm Mekanik dhe Manovrator*
- Lumturi DODA Manovrator*
- Robert DODA Manovrator*
- Jonis HOXHA Manovrator*
- Qerim DODA Manovrator*
- Kastriot CANI Manovrator*
- Atli T. ANUSHI Specialist Ndertimi*
- Ervin SHINI Arkitekt*

- Arben LEKA lng.Elektrik
- Harnit SKANA lng.Hidroteknik

Stafi i mesiperm është disponibel vetem per kete kontrate dhe krahasueshmerisht dukshem me mire se operatori tjetër ekonomik i cili ka shume kontrata ne zbatim dhe staf qe nuk është ne Shqiperi por ne Kosove.

Në përmbushje të pikës së mësipërme nga ana jonë është paraqitur metodologjia e punës (bashkëlidhur ankesës) për mirëmbajtjen dhe rehabilitimin errugëve por pa u kufizuar në to në vecanti këto shërbime lidhen me elementët e rrugës si

Asfaltimet, bankinat, sinjalistika dhe furnizimi pajisjet për sigurinë rrugore, strukturat e drenazhimit, kontrolli i vegjetacionit, skarpatat veprat e artit (muret mbajtës pritës, tombinot e tjerë), urat në vecanti, menaxhimi i trafikut, pastrimi i dëborës.

Mbikëqyrja e segmentit seksionit rrugor në periudha të caktuara sipas niveleve të shërbimit:

Vëzhgimi i faktorëve metereologjikë

Ndihma e parë në rast aksidenti, mërëmbtje në kushtet e dëshiruara të shtresave rrugore, mirëmbajtja e hapsirave të pasrkimit, shërbimit, shenjat rrugore, sistemet e ndricimit, sinjalizimit të ardhshëm e telekomunikacionit riparaime dhe rindërtim pas aksidenteve rrugorë, riparime dhe rindërtim pas fatkeqësive natyrorë., operacionet e pastrimit të drenazheve tmbinove dhe objekteve të tjera që lidhen me largimin e ujërave nga sipërfaqja e rrugës,

Të gjitha operacionet për pastrimin e mirëmbajtjen e:

Shenjave rrugore, pajisjeve të sigurisë(trafikndarëse parapete) sistemit të ndricimit zëvendësim llampash, riparime të vogla përcjellësisht, riparim lokal i dëmtive të trotuarit, kujdesi për bimësinë, aktiviteti në dimër për largimin e dëborës dhe akullit.

Ndërsa punimet e mirëmbajtjes në kushtet dimërore jemi fokusuar në:

Punime paraprake para fillimit të kushteve të dimrit, organizimi i vendndodhjeve të depozitimit të materialeve (kripës inerteve) dhe pajisjeve borëpastruesëve, masat mbrojtëse për borën akullin grumbullin e borës dhe ortekët, masat mbrojtëse kundër ngricave në rrugë në temperatura shumë të ulëta, pastrimi dëborës nga karrexhata e autostradës dhe sinjalet e komunikacionit dhe shenjat, shënjimi i anëve të karrexhatës, sigurimi i funksionimit të drenazhimit nga karrexhata, heqjen e automjeteve nga rruga , instalimi i sinjaleve të vecantatë komunikacionit në rastet e rregjiimit të trafikut të vecantë të mbylljes së rrugës, informimi i vazhdueshëm i publikut për gjëndjen e rrugës dhe rrjedhën e trafikut, nëpërmjet informimit ditor në ARRSH.

Është parqitur plani i rriskut dhe sigurisënë punë qëllimi i të cilit është të garantojë me të gjitha mjetet sigurinë dhe shëndetin e personelit si dhe trajtimin e duhur të aksidenteve dhe riparimin e ndonjë dëmtimi të aseteve dhe palëve të përfshira (psh kontraktori korporatat publike, kompanitëetj). Në menaxhimin e aktiviteteve tona angazhohemi për plotësimin e parimeve e mëposhtme:

Ndjeki qëllimin e asnjë dëmtimi ndaj njerëzve komunitetit dhe aseteve, mbroje mjedisin, promovimin e një kulture në të cilën të punësuarit e saj ndajnë këtë angazhim, nxitjen e mirëqënies së punonjësve si pjesë thelbësore e aktiviteteve të biznesit, të jetë në përputhje me legjislacionin kombëtar european dhe rregullave dhe kërkesave të tjera. Politika e kompanisë sonë kërkon nga të gjithë të ndalojnë cdo punë ose për të parandaluar fillimin e punës kur nuk janë marrë masat e nevojshme për rreziqet e pparnishme. Nga ana jonë është paraqitur

një plan i detajuar me të drejta e detyrime personel e pajisje me ëllim përmbushjen më së miri të këtij kriteri.

Po kështu kapacitetet teknike sa i perket mjetet dhe pjesjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates, jane paraqitur te gjitha thuaje ne pronesi të operatorit ekonomik Ne e dime qe LPP-ja dhe nga ana juaj eshte lejuar qe keto kapacitetete jene të siguruara dhe nëpërmjet qirase, por sidoqofte pasja ne pronesi e tyre, eshte kosto shtese e jona, si siguri absolute per realizimin e kontrates gje e cila duh et te vleresohet nga ana juaj, e shprehur ne piket maksimale.

Ne lidhje me treguesit dhe analiza cilesore ne pune duke percaktuar elementet e saj si per shembull por pa u limituar ne cilesine e propozimit teknik per sa i perket rmetodave te perdorura, personelit kryesor, disponueshmerise se pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit te cilesise, planit te mobilizimit, grafikut te punimeve dhe cdo aktiviteti tjeter sic mund te percaktohet nga punedhenesi, nga ana jone jane paraqitur te gjithë elementet e sipercituar, duke permbushur kriterin e dhene nga ana juaj.

Referuar kriterëve të dhëna në dokumentat e tenderit edhe për këtë kriter operatori ynë ekonomik duhej vlerësoj me 20 pikë dhe në cdo rast më shumë se konkurenti.

Nga KVO-ja duhet te mbahej parasysh vleresimi me nje standandart, sic kane vepruar me operatorete e tjere ne kontrata te mirembajtjes neTropoje, Kukes, Korce, Sarande etj, duke vleresuar me me shume pike, pikerisht operatorete lokal, me argumentimin qe e njohin me mire dhe jane ne gjendje te organizojne me mire kantierin. Operatori konkurues rezulton qe eshte nga Kosova dhe te gjitha punet ne vendin tone nuk kryen vete, po nepermjet nenkontraktoreve dhe kjo gje dihet fare mire nga ana tyre.

KVO-ja gjatë vlerësimit nuk ka zbatuar sic duhet nenin 55 të LPP-së rereferojmë[...]

Po kështu referojmë dhe pikën 2 [...].

po kështu referojmë neni 1.2. [...]

Ne keto kushte rrjedhimisht vleresimi ndaj operatorit tone ekonomik Doda R shpk, duhet te ishte 100 pike dhe ne cdo rast me shume se operatori tjeter konkurrues.

KVO-ja nuk ka zbatuar sic duhet nenin 55 pika 1/b po ashtu dhe pikën 2 të LPP-së i referojmë[...].

Gjithashtu neni 1.2 të LPP-së i referojmë [...]

Gjykojmë që vlerësimi i AK-së (KVO-së dhe KSHA-së) për këtë procedurë prokurimi është i pabazuar në LPPdhe në vkm-në RrPP-në , po kështu në shkelje të kriterëve të vlerësimit të dhëna në ds të kësaj procedure. E themi këtë pasi procedura e ndjekur nga ARRSH është tërësisht e sajuar dhe jo e mbështetur në dispozitat ligjore. KVO-ja pasi lexon ofertat ekonomike bën vlerësimin me pikë të kriterëve të tjera dhe jo bazuar në formulën e dhënë por afrofe duke mos zbatuar asnjë kriter fiks për pikëzim. Në këtë mënyrë duket qartë që shpall fituesiin e paracaktuar pavarsisht ofertës së dhënë sic jemi në rastin konkret. Në këto kushte kur oferta ekonomike janë hapur dhe janë bërë të njohira pikët për kriteret teknike kanë humbur objektivitetin dhe minimalisht duhet të jenë të barabarta që në fund të fundit të fitojë oferta më e ulët ekonomike.

Vlerësimin e ligjshmërisë së procedurë

Rivlerësimin e ofertës së praqitur nga ana jonë si oferta më të favorshme me një pikëzim më të lartë duke bërë riklasifikimin përkatës.

Detyrimin e zbatimit të vendimit të dhënë nga ana juaj[...]

II.9. Njëpërmjet shkresës nr. 8750/1 prot., datë 16.11.2020, protokolluar me tonën me shkresën nr.1442/2 datë 17.11.2020 me objekt “*Informacion mbi zhvillimin e procedurës*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Doda-R” sh.p.k. mbi kundërshtimin e vendimit të KVO lidhur me vlerësimin e tij në pikë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 3, pika 18 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Procedurë e kufizuar*” është procedura, përmes së cilës çdo operator ekonomik mund të kërkojë të marrë pjesë, por vetëm operatorët ekonomikë të përzgjedhur nga autoriteti kontraktor mund të dorëzojnë oferta.

III.1.2. Në nenin 31 “Kriteret për Vlerësimin e Ofertës”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *Kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme do të përdoret në kontrata komplekse dhe të një natyre të veçantë që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmbajnë dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit kontraktor shpenzime të tilla, si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetjen teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin.*

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë.

Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.

III.1.3. Në dokumentat e tenderit, kreu II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 4, “Kriteret e vlerësimit”, janë përcaktuar kriteret e vlerësimit si më poshtë:

Kjo procedurë përfshin dy faza kryesore

Faza 1 – Parakualifikimi: Kandidatët do të dorëzojnë dokumentat e kërkuara në DT. Autoriteti Kontraktor do të shqyrtojë dokumentat e dorëzuara nga Kandidatët dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e kualifikimit të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Faza 2 - Ftesa për Ofertë: Autoriteti Kontraktor do të dërgojë një ftesë për ofertë tek Kandidatët, të cilët, kanë plotësuar kërkesat për parakualifikim duke i ftuar të dorëzojnë një ofertë teknike dhe ekonomike. Ofertat do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Autoriteti Kontraktor për të përcaktuar ofertën fituese.

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) **çmimi më i ulët**

Ose

B) **oferta ekonomikisht më e favorshme** *X*

lidhur me rëndësinë: Çmimi **pikë**

etj. **pikë**

Kriteret e Vleresimit

Pikët

(i) **Çmimi më i ulët**

[0-60]

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë ofertën.

(ii) **Pervoja ne pune e kompanise**

[0-20]

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë punet e relalizuuar ne forme CV, shoqeruar me vertetim punimesh, te kryera ne 10 viteve te fundit.

(iii) **Cilësia**

[0 - 20]

Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.

III.1.4. Referuar bazës ligjore të sipërcituar ku parashikohet se faza e dytë e procedurës së prokurimit objekt ankimi në tërësi i nënshtrohet vlerësimit të tre elementëve kryesorë, të tillë si oferta ekonomike më e favorshme, Pervoja ne pune e kompanise dhe cilësia e cila përfshin treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.

Komisioni i Prokurimit Publik në analize të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Doda-R” sh.p.k. në fazën e dytë të procedurës së prokurimit objekt ankimi, konstaton se në lidhje me komponentin e parë oferta ekonomike më e favorshme ka parqitur formularin e ofertës në vlerën 113.846.713,24 lekë pa tvsh. Ndërsa në lidhje me komponentin e dytë Pervoja ne pune e kompanisë- Operatori ekonomik duhet të përshkruajë punet e realizuar ne forme CV, shoqeruar me vertetim punimesh, te kryera ne 10 viteve te fundit, operatori ekonomik “Doda –R” sh.p.k. ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë :

- CV e Kompanisë në të cilën përshkruan eksperiencat lidhur me përvojën e ngjashme si vijon:
- Formular vlerësimi lëshuar nga Drejtoria Rajonale Rrugore Dibër me objekt Mirembajtje dimërore pastrim i borës aksi rrugor Ura e Cerencit-Stebleve me vlere 24.924.811 leke, viti 2012.
- Formular vlerësimi lëshuar nga Bashkia Dibër, vlere e realizuar 13.164.641, me objekt Kanalizime të ujërave të zeza përgjatë përroit të Tominit dhe sistemimi i tij (faza e dytë) viti 2016.
- Formular vlerësimi lëshuar nga Albanian Mobile Communication sha vlere e realizuar 20.851.599 me objekt Kontratë Shërbimi për mirëmbajtjen e rrugëve të antenave të AMC viti 2011.
- Formular vlerësimi lëshuar nga Drejtoria e Rajonit Rrugor Dibër Vlere e realizuar 11.490.951 me objekt Mbushje me cakull vendosje tombino ura e Cerencit Stebleve viti 2012.
- Formular vlerësimi lëshuar nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Peshkopi vlere e realizuar 21.520.342 me objekt Mirëmbajtje dhe sistemim i sheshit para godinës 5 kat Spitali Rajonal Peshkopi viti 2012
- Formular vlerësimi lëshuar nga Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër vlere e realizuar 23.656.239 me objekt Mirëmbajtje rutine dhe dimërore me performancë rruga Kuben-P.Kapsi –Vleshë Vasije (35.4 km) (nënkontraktor) viti 2019
- Formular vlerësimi lëshuar nga Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër vlere e realizuar 30.981.947 me objekt Mirëmbajtje rutine dhe dimërore rruga Kuben-Vasie (34.3km)

J.V. “Doda Ndërtim” sh.p.k. 51%, vlera e realizuar 15.800.793 lekë “Euraldi” sh.p.k. 49%. 15.181.154 lekë viti 2013 – 2015 (veërtetim datë 24.06.2016+fatura tatimore)etj

- Formular vlerësimi lëshuar nga Komuna Zall Recme vlera e realizuar 17.799.406 me objekt Ndërtim i shkollës C.U. Fshati Bardhaj Rec Komuna Zall REC viti 2012
- Formular vlerësimi lëshuar nga Bashkia Dibër vlera e realizuar 14.038.747 me objekt Rehabilitim i ambienteve të jashtme dhe terreneve sportive të shkollës së mesme Maqellarë 2018 viti 2018
- Formular vlerësimi lëshuar nga SHA Ujësjellës Kanalizime Dibër vlera e realizuar 2.488.000 me objekt Rehabilitim i ujesjellsit të Sopanikës viti 2018
- Formular vlerësimi lëshuar nga Bashkia Dibër vlera e realizuar 38.169.546 me objekt Kanali Muhurr-Brezhdan, pjesa e Gjaricës dhe riparimit i sifonit Gjaricë-Vakuf, Kanali ujitës Sete-Dardhë, Dibër, viti 2017-2018
- Formular vlerësimi lëshuar nga Bashkia Dibër vlera e realizuar 13.314.879 me objekt Rikonstruksion i varrezave publike të qytetit Peshkopi viti 2017
- Formular vlerësimi lëshuar nga Bashkia Dibër vlera e realizuar 3.864.240 me objekt Rindërtim i Urës HD=5M, në fshatin Krej-Lure, NJ.A. Lurë, Bashkia Dibër viti 2017
- Formular vlerësimi lëshuar nga z. Andrea Manga vlera e realizuar 15.607.440 me objekt Rikonstruksion shtesë+ngritje në kat 3(4) e objektit ekzistues Lagjia Treg Peshkopi viti 2018.
- Formular vlerësimi lëshuar nga Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër vlera e realizuar 35.788.773 lekë me objekt Mirëmbajtje rutine dhe dimërore me performancë rruga Kuben- Vasije (35.4 km) (nënkontraktor)viti 2019 (nënkontraktor shoqëruar me kontratë +procesverbal +fatura tatimore)

-Metodologjia e punës për mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve.(54 fletë)

III.1.7. Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se referuar objektit të prokurimit operatori ekonomik “Doda-R” sh.p.k. nuk shfaq një eksperiencë shumë të gjatë dhe të thelluar në fushën e mirëmbajtjes së segmenteve rrugore në përputhje me objektin e prokurimit. Me dokumentacionin e paraqitur ky operator dëshmon se ka realizuar më së shumti kontrata me objekt rikonstruksion të objekteve civile, por shumë pak në fushën e infrastrukturës rrugore sic mund të jenë kontrata me objekt ndërtim rrugësh të cilat konsiderohen të ngjashme me natyrën e kontratës objekt ankimi. KPP vëren se nga tërësia e eksperiencave të paraqitura operatori ekonomik “Doda-R” sh.p.k. dëshmon se ka një eksperiencë të vogël në fushën e mirëmbajtjeve rrugore.

Komisioni gjykon se procesi i pikëzimit është bërë në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi. Fryma e LPP është e tillë që çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për “Përvoja për punë të ngjashme” në fushën e mirëmbajtjes së segmenteve rrugore nuk është plotësuar në

makismumin e mundshëm nga operatori ekonomik “Doda-R” sh.p.k., e rrjedhimisht pretendimi i tij për një pikëzim maksimal lidhur me këtë komponent nuk është i justifikuar. Ndërkohë parë në rafsh krahasimor dokumentacioni i ofertuesit BOE “Alko Impex General Construction”dshh & “Alko Impex Construction”sh.p.k.

KPP vëren se ky i fundit në funksion të komponentit lidhur me eksperiencën e ngjashme referuar CV (LISTA) PUNET E NGJASHME ka paraqitur si vijon:

1. DREJTORIA E RAJONIT QENDROR TIRANE me objekt: Mirëmbajtje bazuar në performancë në segmentet rrugore K/Shirgjan (K/Rr.Nr.70) - Llixha , Llixha - Kaçivel (k.Gramsh),K/Llixhë - Mjekëz (Uzinë), Elbasan - Gjinar, k/Drizë (k/rr. 59) - Kaçivel (K/Elbasan),Gramsh - Kodovjat (shkolla) , Kodovjat (shkolla) - Mollë Grabovë, K/Drizë - Poroçan (88.95 km) (Kontrata 7) (2017) me vlerë 120,483,948 lekë shoqëruar formular vlerësimi kontratë fatura tatimore
2. DREJTORIA E RAJONIT QENDROR TIRANE me objekt 1. Mirëmbajtje bazuar në performancë në segmentet rrugore Park. Mallrave (Unaza Jug. EL) - Komuna Qukës, Komuna Qukës - Prrenjas - Urakë, Urakë - Rotondo Qafë Thanë (58.5km) (Kontrata 14) 2016) me vlerë 39,467,850, shoqëruar formular vlerësimi kontratë fatura tatimore
3. Punime Shtese ne objektin Mirëmbajtje bazuar në performancë në segmentet rrugore Park. Mallrave (Unaza Jug. EL) - Komuna Qukës, Komuna Qukës - Prrenjas - Urakë, Urakë - Rotondo Qafë Thanë (58.5km) (Kontrata 14) (2017 m vlerë 8,049,000lekë, shoqëruar formular vlerësimi kontratë fatura tatimore
4. DREJTORIA E RAJONIT QENDROR TIRANE me objekt: Mirëmbajtje bazuar në performancë në segmentet rrugore Cërrik (k/Belsh) - Shalës - Belsh (L.Tafan), Belsh (L.Tafan) - Grekan, Grekan - Dragot (kufi Kuçove), Belsh - Deg. Rruga Fierzë, Deg. Rruga Fierzë - Kosovë - Kosovë e vogël,Grekan-DëshiranVlashuk, K/Shtërmën - K/RadioStacion, Gostimë - Mollas,Mollas - Selitë , Kthesa Rrasës - Kryq. Rruga Belsh - Pajovë (77.7 km) (Kontrata 8) (2018) me vlerë 43,165,620 lekë shoqëruar formular vlerësimi kontratë fatura tatimore
5. AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR me objekt Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë e akseve rrugore Koplik – Bogë + Dedaj – Razëm 44.2 km (2018) me vlerë 73,099,446 lekë. Shoqëruar me Kontratë fatura tatoimore akt marrje naë dorëzim
6. DREJTORIA E RAJONIT QENDROR TIRANE me objekt Mirembajtje me performance, Kontrata Nr.7 km gjithsej 97.95 (2015) me vlere 35.580.188 lekë shoqëruar formular vlerësimi kontratë fatura tatimore
- 7.
8. DREJTORIA E RAJONIT QENDROR TIRANE me objekt Mirembajtje me performance, Kontrata Nr.8 km gjithsej 117.48 (2015) me vlerë 44.804.559 lekë shoqëruar formular vlerësimi kontratë fatura tatimore

9. DREJTORIA E RAJONIT VERIOR SHKODER me objekt Mirembajtje Rutinë dhe Dimërore me Performancë rruga Kuben – Vasie 35.4 km (2019- Vazhdim) me vlerë 33,556,538 lekë kontratë fatura tatimore
10. DREJTORIA E RAJONIT QENDROR TIRANE me objekt Mirëmbajtje me performancë Vorë-Marikaj (kufi Durrës), Kthesa Kamëz - Vorë (paralele Majtas), Kthesa Kamëz – Vorë (paralele Djathtas), K. Zall Herr (kryq. Rr.Nr.1) – Deg. mj. Komuna Zall Herr, Deg. mj. Komuna Zall Herr – Bovillë, Kryq. Rr. Nr. 52 – Kala Prezë, Bërxullë – Domje, Bërxullë – Laknas, Fushë Krujë (deg. Y) – Fushë Krujë (qendër), K/Thumanë Qendër – Ura e Drojës (aksi i vjetër), Fushë Krujë - Halilaj, Halilaj - Krujë, K/Rr. Kombëtare (e vjetra) – Bilaj (Llixha), K/Rr. Kombëtare (e vjetra) – Fabrika e Çimentos, Bubq - Ishëm, Krujë - Sarisalltik (98.1 km)- KONTRATA 1 (2018- Vazhdim) 24,600,956 lekë kontratë fatura tatimore
11. DREJTORIA E RAJONIT QENDROR TIRANE me objekt Mirëmbajtje me performancë K/Shirgjan (K/Rr.Nr.70) - Llixha, Llixha - Kaçivel (k.Gramsh), K/Llixhë - Mjekës (Uzinë), Elbasan - Gjinar, k/Drizë (k/rr. 59) - Kaçivel (K/Elbasan), Gramsh - Kodovjat (shkolla), K/Drizë - Poroçan (76.45 km) -KONTRATA 5 (2018- Vazhdim) 23,751,738 lekë kontratë fatura tatimore
12. DREJTORIA E RAJONIT QENDROR TIRANE me objekt Mirëmbajtje me performancë Belsh (L.Tafan) - Grekan, Belsh - Deg. Rruga Fierzë, Deg. Rruga Fierzë - Kosovë - Kosovë e vogël, Grekan - Dëshiran - Vlashuk, K/Shtërmen - K/RadioStacion, Mollas - Selitë, Kthesa Rrasës - Kryq. Rruga Belsh - Pajovë, Elbasan - Cërrik (58.7 km)-KONTRATA 6 (2018- Vazhdim) 13,140,738 lekë kontratë fatura tatimore
13. MINISTRIA E INFRASTRUKTURES me objekt: Mirembajtja Verore & Dimerore e Rrugeve Nacionale dhe Regjionale te Kosoves 2017/2018, Regjioni Mitrovica 1 me vlerë 419,797.90 € shoqëruar me kontratë dhe raport përfundimtar 420.274.70€
14. MINISTRIA E INFRASTRUKTURES me objekt Mirembajtja Verore & Dimerore e Rrugeve Nacionale dhe Regjionale te Kosoves 2018/2019, Regjioni Mitrovica 1 me vlerë 1,444,928.53€ shoqëruar me kontratë dhe raport përfundimtar
15. MINISTRIA E INFRASTRUKTURES me objekt Mirembajtja Verore & Dimerore e Rrugeve Nacionale dhe Regjionale te Kosoves 2019/2020, Regjioni Mitrovica 1 me vlerë 1,364,733.51€
16. MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE POSTTELEKOMUNIKACIONIT me objekt Sherbimet e "Mirembajtja Verore Dhe Dimerore e Rrugeve Magjistrale dhe Regjionale per vitin 2009/2010" Regjioni Mitrovica A me vlerë 1,335,755.43€ shoqëruar kontratë, referencë

17. MINISTERIA E TRANSPORTIT DHE POSTTELEKOMUNIKACIONIT Aneks-Kontrate A1 mbi vazhdimin e Kontrates "Mirembajtja Verore Dhe Dimerore e Rugeve Magjistrale dhe Regjionale per vitin 2010/2011" Regjioni Mitrovica A me vlerë 1,335,755.43€ shoqëruar kontratë, referencë
18. MINISTERIA E INFRASTRUKTURES Aneks-Kontrate A2 mbi vazhdimin e Kontrates "Mirembajtja Verore Dhe Dimerore e Rugeve Magjistrale dhe Regjionale per vitin 2010/2011" Regjioni Mitrovica A me vlerë 133,575.54€
19. MINISTERIA E INFRASTRUKTURES me objekt Mirembajtja Verore & Dimerore e Rugeve Nacionale dhe Regjionale te Republikes se Kosoves 2011/2012, Regjioni Mitrovica A, me vlerë 1,177,776.79€ shoqëruar me kontratë referencë
20. MINISTERIA E INFRASTRUKTURES me objekt Mirembajtja Verore & Dimerore e Rugeve Nacionale dhe Regjionale te Republikes se Kosoves 2012/2013, Regjioni Mitrovica me vlerë A 1,177,742.68€
21. MINISTERIA E INFRASTRUKTURES Punime Shtese "Mirembajtja Verore & Dimerore e Rugeve Nacionale dhe Regjionale te Republikes se Kosoves 2013, Regjioni Mitrovica A" me vlerë 117,777.71€
22. MINISTERIA E INFRASTRUKTURES me objekt Mirembajtja Verore & Dimerore e Rugeve Nacionale dhe Regjionale te Republikes se Kosoves 2013/2014, Regjioni Mitrovica A me vlerë 1,386,640.10€
23. MINISTERIA E INFRASTRUKTURES Punime Shtese Mirembajtja Verore & Dimerore e Rugeve Nacionale dhe Regjionale te Republikes se Kosoves 2013/2014, Regjioni Mitrovica A me vlerë 128,915.44€
24. MINISTERIA E INFRASTRUKTURES me objekt Mirembajtja Verore & Dimerore e Rugeve Nacionale dhe Regjionale te Republikes se Kosoves 2014/2015, Regjioni Mitrovica 1 me vlerë, 960,186.61€ shoqëruar me kontratë referencë
25. MINISTERIA E INFRASTRUKTURES me objekt Mirembajtja Verore & Dimerore e Rugeve Nacionale dhe Regjionale te Republikes se Kosoves 2015/2016, Regjioni Mitrovica1 me vlerë 1 650,540.90€ dhe me referencë vlere 650.540.90€
26. MINISTERIA E INFRASTRUKTURES me objekt Mirembajtja Verore & Dimerore e Rugeve Nacionale dhe Regjionale te Republikes se Kosoves 2016/2017, Regjioni Mitrovica 1, me vlerë 1,004,294.05 € shoqëruar me referencë

KPP vlen të sqarojë se ka një dallim të qartë midis kriterëve të vecanta për kualifikim në drejtim të dëshmisë së eksperiencës së ngjashme gjatë tre viteve të fundit të hartuar në përputhje me nenin 46 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 28 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, dhe kriterit të përcaktimit të ofertës fituese. Në rastin konkret, KPP gjen me vënd të sqarojë se nga ana e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në fazën e parë të procedurës së prokurimit, janë vlerësuar nga ana e autoritetit kontraktor se disponojnë eksperiencë të ngjashme, për rrjedhojë vlerësimi i kapacitetit teknik me pikë në fazën e dytë do të mbështet në një vlerësim të qëndrueshmërisë së eksperiencës teknike në 10 vitet e fundit në kontrata të ngjashme, dëshmisë se operatorët ekonomikë disponojnë eksperiencë dhe aftësi teknike për realizimin me sukses të kontratës, parë kjo gjithashtu edhe në rrafsh krahasimor me operatorin tjetër ekonomik.

Nga analizimi në detaje të eksperiencës së ngjashme të dhjetë viteve të fundit të dy operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi parë në rrafsh krahasimor rezulton se nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë BOE Alko-Impex General Construcion” sh.p.k. & “Alko-Impex Construcion” dshh janë paraqitur dëshmi të eksperiencës së mëparshme me 26 kontrata të së njëjtës natyrë, ndërkohë nga ana e operatorit ekonomik “Doda-R” shpk janë dorëzuar 14 kontrata të ngjashme, nga të cilat vetëm 4 të së njëjtës natyrë. Parë në rrafsh krahasimor KPP konstaton se dukshëm nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë BOE Alko-Impex General Construcion” sh.p.k. & “Alko-Impex Construcion” dshh është dëshmuar një eksperiencë më e gjatë dhe e konsoliduar në fushën e ofrimit të shërbimit të mirëmbajtjes rrugore, si në vlerë ashtu edhe në natyrë, krahasimisht me atë të operatorit ekonomik ankimues.

Sa më sipër KPP gjykon se KVO pranë autoritetit kontraktor me të drejtë ka vlerësuar eksperiencën e ngjashme të ofertuesit BOE Alko-Impex General Construcion” sh.p.k. & “Alko-Impex Construcion” dshh. me pikët maksimale dhe më tepër se operatori ekonomik “Doda-R” sh.p.k. pasi dokumentacioni i paraqitur nga BOE dëshmon qartë eksperiencë më të madhe në fushën e mirëmbajtjes së akseve rrugore e rrjedhimisht edhe vlerësimi lidhur me këtë ofertues duhet të jetë më i lartë.

Komisioni gjykon se procesi i pikëzimit në është bërë në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi. Fryma e LPP është e tillë që çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për “Përvoja për punë të ngjashme” në fushën e mirëmbajtjes së segmenteve rrugore është plotësuar më mirë nga BOE Alko-Impex General Construcion” sh.p.k. & “Alko-Impex Construcion” sh.p.k., e rrjedhimisht pikëzimi maksimal lidhur me këtë komponent është i justifikuar.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimin mbi metodologjinë e propozuar, KPP vëren se operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë dorëzuar një kapitull të veçantë të propozimit teknik në të cilin japin përshkrimin e detajuar të përqsjes teknike, metodologjisë, planit të punës si edhe aftësisë organizative të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës..

Referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ka përzgjedhur procedurën e “Kufizuar” në përputhje me nenin 31 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, si edhe ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese, ofertën ekonomike më të favorshme në kuptim të nenit 55 pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Kështu, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor në përcaktimin e ofertës fituese ka përzgjedhur tre komponentë, çmimi më i ulët i cili referuar dokumentave të procedurës së prokurimit zë 60 % të peshës së vlerësimit, (ii) Pervoja në punë e kompanisë e cila zë 20 % të peshës së vlerësimit dhe cilësia e cila zë gjithashtu 20 % të peshës së vlerësimit. Në respekt të nenit 31 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik nënvizon se është në të drejtën e autoritetit kontraktor në cilësinë e autoritetit përgjegjës për prokurimin e fondeve publike në kuptim të nenit 12 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar që të përzgjedhë në përputhje me nenin 55 të ligjit për prokurimin publik mes kriterit të përcaktimit të ofertës fituese: çmimi më i ulët ose oferta ekonomike më e favorshme. Diskrecioni i lënë nga ligjvënësi (mes përzgjedhjes së kriterit të përcaktimit të ofertës fituese) i nënshtrohet parimit të ligjshmërisë, në zbatim edhe të nenit 11 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë. Konkretisht, diskrecioni për të përcaktuar kriteret e përzgjedhjes në rast të aplikimit të ofertës ekonomike më të favorshme si kriter i përcaktimit të ofertës fituese, është kufizuar nga ligjvënësi në mënyrë eksplicite, në nenin 55 të ligjit për prokurimin publik, ku *inter allia* shprehet se *oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kritere të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistencë teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht që këto kritere të jenë objektive dhe jodiskriminuese.*” Gjithashtu, edhe në nenin 31 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar se “*Kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme do të përdoret në kontrata komplekse dhe të një natyre të veçantë që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmbajnë dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit kontraktor shpenzime të tilla, si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetjen teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin.*” Sa më sipër, në respekt të nenit 55 të ligjit për prokurimin publik si edhe nenit 31 të rregullave të prokurimit publik, është në të drejtë të autoritetit kontraktor të përcaktojë kritere të përcaktimit të ofertës fituese si edhe të japë peshë specifike me një sistem të posaçëm pikëzimi.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se fakti se autoriteti kontraktor ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese atë të ofertës ekonomike më të favorshme vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë duhet ti nënshtrohen një analize të thellë dhe të detajuar dy planëshe, së pari mbi vetë dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes mbi kriterin e kërkuar (eksperiencia e ngjashme ose cilësia) dhe së dyti në rrafsh krahasimor edhe me dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik vlerësuar me pikët maksimale, duke bërë kështu një analizë të thellë midis ofertave dhe dokumentacionit të paraqitur, në rastet kur operatorët ekonomikë kanë ngritur pretendime. Në këtë mënyrë, do të garantohen edhe dy prej parimeve ky ç të zhvillimit të procedurave të prokurimit ajo e transparencës dhe barazisë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se (ratio legis) e përdorimit të kriterit të përcaktimit të ofertës fituese si oferta e konomike më e favorshme lidhet pikërisht me kompleksitetin e kontratës, ku krahas cmimit të kryerjes së shërbimit, një rol të rëndësishëm luajnë gjithashtu edhe cilësia e shërbimit, zgjidhjet teknike për të cilat autoriteti kontraktor ka përzgjedhur të peshojë me 20 % të pikëve cilësinë dhe metodologjinë e kryerjes së shërbimit.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ndonëse vlerësimi me pikë megjithëse bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsytuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit.

Në lidhje me cilësinë, si në dokumentet e procedurës së prokurimit, ashtu edhe në ftesën për ofertë autoriteti kontraktor ka përcaktuar se vlerësimi do të kryhet mbi treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në rastin konkret në vlerësimin e metodologjis së dorëzuar do të merren në konsideratë elementët konkretë për të gjithë treguesit cilësore të punës, zbërthyer kjo në të gjitha elementet e saj. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se synimi i autoritetit kontraktor nuk lidhet me ri prodhimin e termave të referencës së kryerjes së shërbimit, por në drejtim të përmirësimit të tij, ri organizimit, sigurimit të cilësisë ose elementë të tjerë favorizues, që në thelb do të përbënin ofertën ekonomikë më të favorshme dhe do të garantonin cilësinë e kryerjes së shërbimit.

Nga analizimi në rrafsh krahasimor i metodologjive të dy operatorëve ekonomikë të kualifikuar në fazën e dytë, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor ka vlerësuar me pikë të njëjta (18 nga 20) pikë në lidhje me metodologjinë e dorëzuar. Nga analizimi i të dy metodologjive, konstatohet se operatorët ekonomikë kanë dorëzuar një analizë të detajuar të proceseve të kryerjes së shërbimit duke dëshmuar një përmirësim të ndjeshëm të termave të referencës së kryerjes së shërbimit nga ana e autoritetit kontraktor, të dy metodologjitë përmbushin kriteret minimale të kërkuar nga autoriteti kontraktor si edhe të dy ofertuesit kanë deklaruar të njëjtën periudhë (grafik) të kryerjes së shërbimit. Sa më sipër, KPP gjykon se vlerësimi i autoritetit kontraktor është në proporcion me dokumentacionin e dorëzuar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Doda-R” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “E Kufizuar (mbi kufirin e lartë monetar)”, me nr.REF-65283-07-13-2020, me objekt Loti XII “Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga "Kuben- Vasie” me fondin limit 117.790.800 Lekë pa tvsh , zhvilluar në datën 28.09.2020 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr.1442 Protokoli, Datë 09.11.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri